# 15 VJETORI I THEMELIMIT

## TË FONDIT HUMANITAR MALËSIA

# *BOTIM JUBILAR*

16 Maj, 2009

Fondi Humanitar Malësia
261 Gun Hill Rd.
Bronx, NY. 10467

*www.fondihumanitar.org*

V&T PIZZERIA & RESTAURANT

ITALIAN FOOD AT ITS BEST

• FULL MENU
• PRIVATE PARTY ROOM

WE DELIVER

OPEN 7 DAYS

1024 Amsterdam
(Between 110-111th Str.)
New York, NY

212-663-1708
212-666-8051



URIME 15 VJETORIN!

Lekë Gjolaj



**Kryetar:** Leonard Berishaj

**Nënkryetar:** Martin Junçaj

**Arkëtar:** Lekë Gjolaj

**Sekretar:** Gjon Ivezaj

## ANËTARË TË KRYESISË:

Ëjëll Berishaj
Daniel Ivezaj
Marjan Berishaj
Mark Berishaj
Pjeter Berishaj
Kolë Cacaj
Luigj Camaj
Gjon Dedvukaj
Zef Gjokaj
Zef Lulgjuraj
Gjergj Junçaj
Lulash Junçaj
Nikollë Junçaj
Vasel Ulaj
Anton Ulaj
Gjokë Nicaj
Halil Nikaj
Shaqir Gjokaj

**Fondi Humanitar Malësia**
261 Gun Hill Rd.
Bronx, NY. 10467
www.fondihumanitar.org

# Mesazh i Kryetarit të Fondit Humanitar "Malësia" me rastin e 15 vjetorit të themelimit

Shumë të nderuar anëtarë dhe dashamirë të Fondit Humanitar "Malësia",

Meqenëse kemi hyrë në 15 vjetorin e ekzistencës sonë dhe si gjithmonë duke shikuar përpara është me rëndësi për ne të shikojmë pakëz mbrapa dhe të numërojmë disa të arritura të organizatës sonë. Po ashtu do të dëshiroja që të jap një vizion konciz për dy vitet e ardhshme.

Duke mos pasur qëllim të harrojmë të gjitha të arriturat e FHM gjatë këtyre pesë viteve të fundit, vlen të përmendet se së pari është vazhduar me projektet e arsimit të të rinjve malësorë ku gjatë kësaj periudhe janë ndarë 102 bursa studentore; së dyti u organizuan drejtpërdrejtë së paku dy manifestime kulturore, ku në të parën përkujtuam figurën madhore të humanistit z. Gjergj Dak Gjokaj, ndërsa në të dytën bëmë promovimin e romanit më të ri të autorit malësorë Fran Camaj; dhe së treti organizimin e fushatës së ndihmës jo vetëm të Shtëpisë Televizive BOIN por edhe vet pronarit të tij, z. Tomë Bojaj, i cili tash një vit po ballafaqohet me probleme serioze shëndetësore. Janë pikërisht këto tri kolona të cilat përmbajnë edhe kurrizin e veprimtarisë së FHM, me të cilat dallohemi jo vetëm në komunitetin shqiptar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por si të tille jemi edhe emblematik për krejt shoqërinë shqiptare.

FHM në kolonën e parë synon dhe bënë përpjekje të vazhduara me plane konkrete që të avancohet shkollimi shqip, me ç'rast ne ruajmë identitetin tonë shqiptar të vendlindjes, duke i vënë themel të shëndosh kolonës së dytë të vënies në pah të traditës dhe aktivitetit tonë të gjallë kulturor. Është kolona e tretë, humanizmi, me të cilën shqiptarët më shumë se në çdo fushë tjetër kanë arritur të afirmojnë emrin e tyre në faqe të botës, që e kemi për bazë duke na organizuar dhe mbajtur të gjallë tash 15 vite me radhë, duke na shndërruar në organizatë model, përsëri po e themi, jo vetëm brenda Amerikës por edhe brenda botës shqiptare të tej atlantikut. Tradicionalisht, pas çdo dy viteve, FHM zgjedh kryesinë e re. Ne në Fondin Humanitar duke vepruar në mënyrë të këtillë synojmë që të rinojmë organizatën tonë, jo vetëm me personel të ri, por edhe me ide të reja. Mendojmë se dy vitet e ardhshme do të jenë një sprovë drejt thellimit dhe pasurimit të aktivitetit të FHM, organizimit më të gjerë të tij njerëzor dhe specifikimit të programit afatshkurtër dhe afatgjatë, gjithmonë duke kultivuar edhe më tej trinomin e mësipërm duke i krijuar në këtë mënyrë FHM një të ardhme të sigurt dhe më të suksesshme.

Në kryesinë e re të udhëhequr nga unë, Leonard Berishaj, shikohet që të japë ide konkrete për dy vitet ardhshme, duke u bërë ballë sfidave të kohës, ndërsa neve të tjerëve t'i pranojmë ato në syrin kritik, gjithmonë duke pasur parasysh interesin tonë të përgjithshëm kombëtar. Me këtë rast dëshirojmë të falënderojmë Kryesinë e dy viteve të kaluara të udhëhequr nga z. Kolë Cacaj (kryetar), z. Leonard Berishaj (nënkryetar), z. Lekë Gjolaj (arkëtar) dhe z. Mark Berishaj (sekretar) për punën e tyre të palodhur dhe plot përkushtim në radhët e FHM.

Të gjithë anëtarëve dhe dashamirësve të Fondit Humanitar "Malësia" ju uroj 15 vjetorin e themelimit të Fondit Humanitar “Malësia”!

**Leonard Berishaj**

# Përmbajtja

Mesazh i Presidentit Leonard Berishaj............................
Falënderim.......................................................................
Humanizëm .....................................................................
Rasti i Tomë Bojaj.............................................................
Rasti i Mark Gecaj ............................................................
Raste të Asistencës Sociale.............................................
Kulturë ..............................................................................
Arsim .................................................................................
Studentët Bursistë ...........................................................
Aktivitete në Fushën e Arsimit.........................................
Politikë .............................................................................
Referate dhe kumtesa .....................................................
Korrespondencë ...............................................................

Fondi Humanitar "Malësia" rezervon të gjitha të drejtat mbi botimin e plotë apo të pjesshëm të përmbajtjes së kësaj reviste. Për çdo interesim eventual ju mund të kontaktoni organet përgjegjëse të Fondit Humanitar "Malësia". Teksti prezent në këtë revistë është përgatitur nga Marjan Berishaj. Reklamat dhe printimi është realizuar nga Ismer Mjeku. Të dhënat e pranishme në këtë broshurë bazohen në dokumentacionin arkivor të Fondit Humanitar "Malësia". Korrespondenca e Fondit është zgjedhur, edituar dhe formatuar në përputhshmëri të natyrës dhe hapësirës për prezantim.

Stafi drejtues i broshurës: Leonard Berishaj, Marjan Berishaj, Mark Berishaj, Kolë Cacaj, Gjon Dedvukaj, Shaqir Gjokaj, Zef Gjokaj, Lekë Gjolaj, Gjon Ivezaj, Gjergj Junçaj, Martin Junçaj, Nikollë Junçaj, Zef Lulgjuraj, Vasel Ulaj, Daniel Ivezaj, Luigj Camaj, Pjeter Berishaj, Ejëll Berishaj, Anton Ulaj.

Fondi Humanitar "Malësia" si organizatë jofitimprurëse është i klasifikuar në seksionin 501 (c) 3 të Kodit të Brendshëm Tatimor. Organizata synim kryesor ka ngritjen dhe avancimin kulturor, arsimor, politik dhe ekonomik të shqiptarëve të cilët jetojnë në Mal të Zi, respektivisht në rajonin e Malësisë së Madhe me qendër Tuzin, si dhe diasporën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çdo kontribut financiar pranë Fondit Humanitar është i deklarueshëm kundrejt rimbursimit taksor si për individët dhe korporatat dhe kontributet nga organizatat private trajtohen si distribuime kualifikuese duku iu mënjanuar taksës shtesë.

www.fondihumanitar.org

FALËNDERIM

# Falënderim

Fondi Humanitar "Malësia" falënderon çdo individ i cili në një mënyrë apo në një tjetër ka ndihmuar në realizimin e programeve tona.

Falënderojmë të gjithë anëtarët e Kryesisë së Fondit Humanitar të cilët me sakrifica udhëhoqën organizatën gjatë këtyre 15 viteve.

Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë organizatat joqeveritare shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të tilla si Shoqata Shqiptaro-Amerikane "Malësia e Madhe", Shoqatën "Dedë Gjo'Luli", Fondacionin "Dom Simon Filipaj".

Në mënyrë të veçantë falënderojmë personalitet religjioze, dom Anton Kqirën, famullitarin e Kishës së Shën Palit, at Pjetër Popaj, famullitarin e kishës "Zoja e Shkodrës", të cilët përherë përkrahen aktivitet tona.

Veçanërisht falënderojmë arkëtarin Lekë Gjolaj, z. Luan Isufin, Plannet Fittness, Gruda Limusine Service dhe Giancarlo Hair Studio për kontributin e tyre dhënë lotarisë së zhvilluar gjatë mbrëmjes festive me rastin e 15 vjetorit të themelimit të Fondit Humanitar "Malësia"

Falënderojmë z. Ismer Mjekun në realizimin e pjesës publicistike të Revistës. Dhe me në fund, por jo më së paku falënderojmë realizuesin Marjan Berishaj dhe të gjithë ata të cilët dhanë sugjerime gjatë fazës përgatitore.

Fondi Humanitar "Malësia" falënderon individët dhe sipërmarrësit prezent në këtë revistë me reklamat e tyre. Për të reklamuar në revistën tonë ju mund të kontaktoni Fondin Humanitar "Malësia" në telefonat përkatës si edhe nëpërmes faqes sonë të internetit.

Ju nëpërmes reklamës suaj bëni afirmimin e çështjes suaj si edhe përkrahni aktivitetin tonë në fusha të ndryshme. Revista do të shpërndahet në Nju Jork, Detroit, vende të tjera në Shtete të Bashkuara të Amerikës ku jetojnë një numër i theksuar shqiptarësh, si edhe në vendlindje, në Malësi. Kjo revistë po ashtu mund të lexohet edhe në rrjetin e internetit në adresën e poshtëshënuar.

www.fondihumanitar.org
Tel: 718.519.1100

# HUMANITET

Ndër aktivitete kryesore humanitare të Fondit Humanitar "Malësia" veçojmë kontributin dhe përgjigjen e anëtarëve të Fondit jo vetëm në grumbullimin e mjeteve financiare për televizionin Boin me qëllim për të kapërcyer krizën financiare, krizë e cila rrezikonte mbylljen e kësaj shtëpie televizive por edhe realizimin intervenimeve mjekësore të vet pronarit të tij, z. Tomë Bojaj i cili tash 1 vjet e gjysmë i nevojitet ndihma mjekësore e specializuar.



Televizioni BOIN

**Tomë Bojaj** u lind në Malësi në vitin 1967. Shkollën fillore e mbaroi në Tuz, ndërsa shkollën e mesme turistike në Podgoricë. Me punë audiovizive filloi të merret që në moshë të re, duke arritur kulmin kur në vitin 2001, më 28 nëntor, lëshoi në punë shtëpinë e parë televizive private në gjuhën shqipe në Mal të Zi. Televizioni Boin ishte dhe mbeti dritarja e parë dhe e vetme e informimit dhe argëtimit të shqiptarëve në Mal të Zi. Z. Tomë Bojaj është i martuar dhe prind i 4 nxënësve. Në fillim të vitit 2008 ai u sëmurë rëndë me ç'rast ai ishte i detyruar të kërkojë trajtim të specializuar mjekësor në Shtete të Bashkuara të Amerikës. Fondi Humanitar i dëshiron z. Tomë Bojaj shërim sa më të shpejtë dhe kthim në jetë normale.



Fondi është përfshirë në fushatën për të ndihmuar djaloshin Kristjan Gjeto Camaj i cili kishte probleme shëndetësore.

**Mark Gecaj**
Po ashtu Fondi Humanitar "Malësia" u është përgjigj thirrjeve për të ndihmuar vogëlushin Mark Gecaj i cili vuan nga autizmi.

Fondi gjatë periudhës së fundit pesëvjeçare ka ndihmuar familje të cilët humbën anëtarë në tragjedi të ndryshme, apo familje të cilat janë të paafta për të përballuar vështirësitë jetësore, të tilla si familjet e Drane Gjelaj, Nikë Gjon Gojcaj, familjen e znj Lenë Gj. Lucgjonaj.

Një vëmendje e konsideruar gjatë periudhës dyvjeçare u është kushtuar edhe të burgosurve politik shqiptar në Mal të Zi, ku për familjet e tyre dy herë radhazi është kontribuar me shumën totale prej 70 000 dollarësh amerikan.

Gjithashtu, për lirimin e të burgosurve Fondi Humanitar "Malësia" në bashkëpunim me shoqatën "Dedë Gjo'Luli", shoqatën "Bashkimi Kombëtar", shoqatën "Malësia e Madhe" ka organizuar pesë protesta, tri në qytetin Uashington, dhe dy protesta në qytetin e Nju Jorkut, ku ka kërkuar lirim të menjëhershëm dhe të pakushtëzuar të vëllezërve tonë.




*Gjatë një protestë në Uashington DC*

# KULTURË

## Arritjet Kulturore dhe Folklorike të Shqiptarve në Mal të Zi Gjatë Dy Dekadave të Fundit

**Anton Kolë Lajçaj**

Të nderuar bashkatdhetarë,

E kaluara jonë historike sado e lavdishme, por shumë e vështirë, ka ndikuar që neve të jemi të ndarë, larg njëri-tjetrit, të jemi qytetarë të shumë shteteve, pjesëtarë të shumë shoqërive, pjesëmarrës të shumë kulturave dhe mentaliteteve, ku shpesh-herë mund të dukemi sikur dallojmë edhe kombëtarisht, por një gjë duhet ta dimë dhe ta kemi në mend dhe në zemër, të na përcjellin sikur hije në çdo hap të jetës dhe në çdo vend të botës.

Mund të kemi qindra shtetësi të ndyshme, t'ju takojmë shtatë kontinentëve të botës, të jetojmë në veri, në jug, në lindje apo perëndim, por ekziston diçka më e fortë se të gjitha këto, ajo që na lidh dhe na bashkon si shqiptar. E përbashkëta e pash-mangshme, e pamohueshme dhe e pashlyer është gjaku, gjuha, kultura kombi dhe flamuri. Të gjitha këto janë gjymtyrë të pan-dara për një komb. I kemi të përforcuara në një trup të fortë që është Shqipëria Etnike, me rrënjët që shpjenë deri në ILIRI, në popullin më të lasht në Ballkan.

Dhjetëvjçari i fundit i shekullit XX popullin shqiptar e gjeti në një pozitë shumë të vështirë politike. Në rend të parë populli në Kosovë, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës, Medvegje dhe Bujanovc, dhe në Mal të Zi, kaluan vite të vështira, luftëra dhe masakra, pothuajse një milion shqiptar u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe nga trualli shekullor shqiptar, të tjerët në mënyrë më të ndryshme mbaheshin nën presion duke mos ju mundësuar as të drejtat elementare njerëzore.

Shkollat dhe Universitetet shqiptare në Kosovë mbylleshin, kurse në Mal të Zi kishin një tranzicion të paparë anti-shqiptar. Nuk lejohej përdorimi i literatures në gjuhën shqipe që vinte nga Shqipëria e Kosova. Programi mësimor ishte i orjentuar 97.1% prosllav, d.m.th. vetëm 2,9 % në plan-programet mësimore të shkollave të mesme në Mal të Zi me mësim në gjuhën shqipe mund të mësonin histori dhe kulturë kombëtare. Këta dhe shumë faktorë të tjerë ndikuan negativisht në zhvillimin kul-turor, në ruajtjen gjuhës dhe në edukimin Kombëtar, virtyte këto të pazavëndësueshme për përparimin kombëtar.

Të gjitha këto na sollën asimilimin dhe vetmohimin kombëtar, duke filluar nga Plava, Gucia, Malësia e Madhe, Kraja, Ulqini dhe Tivari, ku për fat të keq në shumë familje shqiptare gjuha e parë është sllavishtja. Kjo do të thotë, gjatë kësaj kohe, te shqiptarët në Mal të Zi aktivitetet kulturore dhe folklorike ishin pothuajse të vdekura, mbizotronte një heshtje, ngjarjet vëzhgo-heshin "me lepur në bark". Në Kosovë, vëllezërit dhe motrat tona digjeshin e piqeshin nga serbo-malazezët vetëm e vetëm se ishin shqiptar.

Duke falënderuar Zotin, gjakun e derdhur të dëshmorëve të UÇk-së në krye me komandantin legjendar Adem Jasharin, SH.B.A-të, NATO-on, dhe juve vëllezër dhe motra, për fat të mirë kjo periudhë dhjëtëvjeçare u kurorëzua me çlirimin dhe më në fund pamvarësinë e Republikës së Kosovës, shtetit të dytë shqiptar, ku shpresoj se një ditë do të jemi të gjithë nën simbolin shtetëror të Shqipërisë Etnike me flamurin kuq e zi dhe shqiponjën dykrenare.

Kjo dekadë për kulturën shqiptare në Mal të Zi u përmbydh pothuajse në frymën e dështimit dhe të heshtjes duke mos patur aktivitete kulturore.

Shoqatat kulturore shqiptare pothuajse nuk vepronin fare sepse nuk ekzistonin kushte ekonomike as klimë politike e përsh-tatshme në vend. Kështu u mbyll e deshtuar sa i takon zhvillimit kulturor folklorik. Në dekaden e dytë (2000-2009) aktivitetet kulturore filluan të ringjallen, të zgjohen nga gjumi i dhjetëvjetorit të luftërave dhe masakrave shqiptare. Në vitin 2001 rifilluan aktivitetet kulturore disa shoqata, shoqëri dhe ansamble kulturore. Në Guci, SH.K.A "Maja e Karanfilit", në Malësi, SH.K.A-të: "Rapsha", "Dedë Gjon Luli", "Gruda", "Besa", "Koha", "Liria", shoqata kulturore "Besa e Trieshit" dhe ansambëli Shqiponja. Në Krajë, SH.K.A "Kraja", në Anë të Malit, SH.K.A "Zgjimi", në Ulqin, SH.K.A "Zana" dhe "Ulqini". Të gjitha kultivonin folklorin burimor dhe të stilizuar shqiptar të vendit ku vepronin.

Organizoheshin aktivitete të ndryshme duke shënuar dhe përkujtuar datat historike kombëtare dhe festat lokale. Në Guci më 1 dhe 2 gusht 2001 organizohej manifestimi me emër "Alpet Shqiptare" ku pjesëmarrësit ishin pothuajse nga i gjith veriu i Shqipërisë Etnike, shpalosej melosi dhe kënga shqiptare, gjëmonin krojet e Ali Pashës nga zëri i fyellit dhe çiftelisë, këngëtarët

shoqëroheshin nga zëri i bylbylit që jehonte nga bjeshkët përreth gjerë në Majën e Karanfilit. Në Ulqin organizoheshin "Ditët e Kulturës së Ulqinit", "Panairi i Librit Shqiptar" etj. Në Anë të Malit organizohej manifestimi kulturor "Pranvera në Shas". Pjesëmarrës në këtë manifestim vinin nga Ulqini, Shkodra, Kraja, Malësia e Madhe etj. Mbaheshin ligjerata mbi qytetin Ilir të Shasit dhe pastaj shoqatat dhe ansamblet vazhdonin me shpalosjen e tyre folklorike me motive të ndryshme, duke filluar me rite të darsmave, të fejesave, të mbjellurit, të korrurit, pagëzimit, synetimit, këngë dhe valle etj. Në Ostros, manifestoheshin, "Ditët e Kulturës në Krajë". Këtu shpalosej folklori Krajan. Larmia e veshjes krajane ja jepte bukurinë e mrekulluashme vendit; zëri i fyellit të krajanit tingëllonte duke ju lënë të gjithëve mbresa dhe duke mbjell në mendjen dhe zemrën e çdo shikuesi atdhedashurinë dhe trimërinë, qëndresën e burrave dhe burrëreshave nga Kraja.

Në Malësi filluan të mbaheshin disa aktivitete kulturore siç janë: "Festa e Flamurit", "Kryengritja e Malësisë", "Java e Kulturës në Malësi", "Logu i Bjeshkëve", "Vera në Cem", "Logu në Tërgajë", "Logu në Vitojë", "Logu te Kroni i Traboinit". Të gjitha këto përputheshin me festat kombëtare dhe lokale, me pjesëmarrës kryesisht nga trevat e Malësisë. Shoqatat filluan të venin bashkëpunim me shoqatat dhe ansamblet kulturore folklorike në mbarë teritorin shqiptar, duke thyer kufinjët administrativ, dhe duke e ndier realitetin e të qenurit të bashkuar. Shumë nga këto ansamble merrnin pjesë në Festivale Kombëtare në Kosovë, Shkup, Tetovë, Shkodër, Tiranë, Gjirokastër etj. Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi vëllezëror u vëndos nga SH.K.A. Rapsha Hot-Malësi e Madhe që në gusht të vitit 2003 të organizohet "Festivali Folklorik Burimor Mbarëkombëtar" gjë i cili ndodhi për here të parë në trojet shqiptare në Mal të Zi. Pjesëmerrës ishin nga të gjitha trojet shqiptare të Shqipërisë Etnike si dhe diaspora e SH.B.A-ve dhe Greqia.

Qëllimi i këtij festivali ishte bashkimi i të gjithë shqiptarve në një sofër të madhe mbarëkombëtare në Malësinë e Madhe, gjegjësisht në Vitojë. Ishte qellimi i thyerjes së kufirit famëkeq që ndante trojet shqiptare. Në këtë vend shpaloseshin këngë dhe valle nga të gjitha trojet shqiptare, nga veriu, jugu, lindja dhe perëndimi. Këngët dhe vallet e artistëve shumë të talentuar ishin më të fuqishme se armët e armikut. Numri i madh shikuesëve kalonte çdo parashikim, u bë shumë madhështore aq sa serbomalazezët kishin zili dhe kërcenin deri në rrënimin e skenës mbarëkombëtare. Për fat të mirë kjo bukuri madhështore përforcoi edhe më tepër themelet e Festivalit Mbarëkombëtar. I vëndosën vulën e përjetësisë dhe pavdekshmërisë së kulturës dhe folklorit në Malësinë e Madhe. Rrjedhim i kësaj është organizimi i tretë me rradhë që do të mbahet pikërisht me datën: 20-23 gusht të vitit 2005. Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar pozitivisht në ringjadhjen dhe ruajtjen e kulturës, folklorit dhe kostumeve kombëtare në trojet tona shekullore.

Njëni nga sponsorët e këtij organizimi ishte Fondi Humanitar "Malësia" dhe do të citojë si dëshmi një fjali nga fjalimi im i mbajtur në fjalën e rastit të Festivalit Mbarëkombëtar "Rapsha 2005" Hot-Malësi e Madhe.

"Zonja dhe zotërinj duke përfunduar, shfrytëzoj rastin të falënderojë të gjithë bashkatdhetarët tanë të mërguar në SH.B.A dhe Europë, shoqatën joqeveritare Malësia e Madhe-Detroit, Fondin Humanitar "Malësia"- Nju Jork, Fondacionin Dedë Gjo'Luli- Nju Jork, tregëtarë dhe afaristë nga Malësia dhe Ulqini të cilët janë donatorë gjeneral të këtij manifestimi kulturor dhe kombëtar. Të nderuar pjesëmarrës, tani më mbetet të shprehi një falënderim të veçant nga zemra Fondit Humanitar "Malësia", për kontributin e dhënë pesëmbëdhjetëvjeçar në përkrahje të vendlindjes, duke ndihmuar studentët tanë me bursa studentore dhe duke përkrahur aktivitetet kulturore kombëtare.

Unë jam dëshmitar i kësaj veprimtarie të lavdishme, sepse për dy vite me rradhë, përfitova përkrahjen financjare gjatë studimeve të mija universitare në Shqipëri, gjegjësisht në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Kjo ditë është një përvjetor i begatshëm dhe tregon punën e palodhur. I gjithë aktiviteti i tyre shkon në të mirë të ruajtjes së gjuhës, kulturës dhe edukimit të brezave të ri në gjuhën amëtare. Tani më lëjoni, që si vëlla i juaji, duke u nisur nga vetja dhe të gjithë Ju të nderuar, të apelojë në angazhimin sa më të madh për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe atëdhedashurisë në vëndin ku jetojmë. Sejcili prej nesh është pjesë e këtij fenomeni. Të trashigojmë te brezat e rinj gjuhën tonë amëtare. Vetëm kështu do të kemi mundësi të mbijetojmë si shqiptar në këtë humnerë të asimilit që ka kapluar botën.

Vëllezër dhe motra, shfrytëzoj këtë rast që juve dhe mbarë shqiptarëve kudo që janë, t'ju uroj nga zemra dy fitoret dhe gëzimet më të mëdha të dy viteve të fundit, të shumëpritura me shekuj: 17 shkurtin 2008, pamvarësinë e Repulikës së Kosovës dhe 2 prillin 2009, anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në NATO. Presim, shpresojmë dhe besojmë në fitoren dhe gëzimin e tretë që do të ishte rindërtimi i Kalasë së Madhe Mbarëkombëtare, gjegjësisht bashkimin e trojeve shqiptare në Shqipërinë Etnike.

Duke përfunduar ju falënderoj përzemërsisht për vëmëndjen tuaj. Juve të gjithëve ju dëshiroj fat, paqë dhe lumturi në familjet tuaja si dhe realizimin e ëndërrave dhe planeve të jetës. Fondit Humanitar "Malësia" i uroj punë të mbarë në vitet e ardhshme në realizimin e aktiviteteve të tyre kombëtare.

Faleminderit!

**Ndër aktivitet kryesore kulturore drejtpërdrejt të realizuara nga Fondi Humanitar veçojmë seminarin për nder të 10 vjetorit të vdekjes së intelektualit Gjergj Dak Gjokaj të mbajtur në dhjetor të vitit 2007.**

Nga fjala përshëndetëse e kryetarit të atëhershëm të Fondit Humanitar " Malësia", z. Kolë Cacaj, veçojmë:

"Kam kënaqësinë që në emër të Fondit Humanitar “Malësia” të përshëndes dhe falënderoj pjesëmarrësit e këtij seminari me rastin e dhjetëvjetorit të vdekjes së humanistit të pashoq, profesorit të të gjithë neve, birit malësor që i mbeti besnik truallit të të parëve dhe traditës më pozitive të kombit shqiptar – Gjergj Dakut Gjokaj.

Profesori ynë, Gjergji ishte njeri i parimeve, njeri i drejtë dhe besnik, i palodhshëm dhe gjithmonë i gatshëm për t’ia shtrirë dorën njeriut në nevojë. Diaspora malësore gjithmonë ishte familje e tij e dytë. I dhembte Gjergjit përçarja që kishte diaspora në vitet e shtatëdhjeta e tetëdhjeta si pasojë e ndikimit të dorës së zgjatur të shërbimeve sekrete antinjerëzore si të UDB-së ashtu të Sigurimit. Në veçanti e pengonte atë, si arkitekt i Besëlidhjes së Malësisë së vitit 1970, fakti se në fillim disa nga malësorët e Amerikës nuk dëshironin ta pranonin Besëlidhjen si të veten.

Gjergji ishte gjithherë i mirëpritur nga diaspora, si nga të rinjtë – ish nxënësit e tij, ashtu edhe nga ata malësorët e vjetër që vuanin për çdo gurë të Malësisë. Ne kishim nderin që të ishte pjesëtarë i aktiviteteve tona të cilave u jepte gjallëri e madhështi. Ai u mundonte ta bashkonte edhe të pabashkueshmen, ta pajtonte edhe të papajtueshmen. Kishte aq energji, sa që na mbushte edhe të gjithë neve me atë energjinë pozitive që rrezatonte vet ai. Andaj, me një fjalë ne kishim nderin të jemi bashkëkohës dhe nxënës të tij. Kishim fatin që e njihnim dhe nderin që na njihte. Kujtimi i tij do të mbetet i pashlyeshëm për diasporën malësore, për hir të kujdesit që gjithmonë paraqiste për të.

Në mënyrë të veçantë falënderoj z. Fran Camaj, ligjëruesin kryesor në këtë seminar, si dhe Shoqatën Illyricumi për përgatitjen e veprës "Gjergj Gjokaj - Një jetë dhuruar Malësisë" për të cilën Fondi mbuloji shpenzimet financiare."

**Aktivitet tjetër të cilin Fondi drejtpërdrejt organizoi ishte edhe promovim i romanit "Mëshira e pamëshirshme" të autorit Fran Camaj**

Shkrimtari Fran Camaj, herën e fundit ne mesin e fondit ishte prezent kur rikujtuam jetën dhe veprën e profesorit të ndjerë Gjergj Dakut Gjokaj. Edhe atëherë Frani na solli libër për këtë figurë të ndritur të popullit tonë. Gjithsesi edhe më parë Fondi Humanitar "Malësia" ka pas lidhje të drejtpërdrejta më autorin, në kohën kur ai ishte në udhëheqje të shoqatës së intelektualëve "Illyricum" kur ne ndihmuam dhe veçanërisht në verën e vitit 2001 kur ne ishim sponsor i vetëm i Ditëve të Kulturës dhe të Sportit në Malësi. Nuk dëshirojmë këtu të thellohemi në historinë tonë të lidhjeve me autorin, vetëm duhet theksuar se autori përveç se merret aktivisht tash disa vite me letërsi është marrë dhe merret edhe me aktivitete të tjera kulturore të shqiptarëve në Mal të Zi e veçanërisht të malësorëve në Malësi. Nga fjala e rastit drejtuar të pranishmëve në këtë seminar të gazetarit dhe veprimtarit të dalluar të komunitetit tonë në Nju Jork z. Gjergj Ulaj veçojmë:

Vëllezër, është nder dhe kënaqësi të marrësh pjesë në një veprimtari të tillë, është vërtetë një ndjesi e bukur të mblidhesh diku me malësoret e tu e të flasësh për libra e për më tepër kur autor është një bir i maleve tona e në ato libra është vet Malësia me të mirat e të këqijat e saj, është Malësia me heronjtë e saj. Autorin e këtyre librave për herë të parë e njoha në Kojë, në fshatin tim, atë ditë kur Malësia nderoi një burrë e luftëtar, Prëtash Zekën.

Fran Camaj me llojin e tij të shkrimtarëve dhe historianëve është i njëllojtë me arkeologun, i cili nuk rresht së kërkuari nën dhe të djeshmen, qoftë kjo e lavdishme apo e mjerë. Të risjellësh në memorien tonë bëmat e paraardhësve tanë është detyrë e kujtdo e për më tepër detyrë e atyre që janë më afër letrave dhe u janë kushtuar atyre. Por ajo që e bënë Fran Camaj më të vlefshëm është fakti se ai jeton e krijon, fatkeqësisht nën pushtim.

Romani “Mëshira e pamëshirshme” për dallim nga romani “Dashuri e dhunuar” ka një natyrë tjetër, të cilin unë e quaj romani i dhimbjes, dhe është i tillë. Është e vërtetë ajo që lexojmë në faqet e këtij romani, e vërtetë irrituese, ka në të më shumë dhimbje dhe revoltë sesa dashuri, bile do të thosha se në të veç linjës së dashurisë së Palit me Bukurien, gjithçka tjetër është ar-

ratisje, dhimbje, urrejtje, reprezalje e asgjë tjetër. Është një histori e thjeshtë e një familjes sonë në Malësi e jo vetëm atje. Emigracion, larg për një jetë më të mirë, arratisje e pafund, shkretim i trojeve, tharje e lëngut jetësor të Malësisë. Gajasje e shkjaut.

Në këtë roman asgjë nuk është e sajuar, vetëm e vetëm u janë vënë personazheve emra fiktivë dhe aq. Gjithçka tjetër është realitet. Një realitet i dhimbshëm, torturues, një realitet fund e krye i ideuar dhe realizuar nga forca të errëta, armike të Malësisë e të malësorëve, forca që mundohen të destabilizojnë gjithçka shqiptare. Janë ata dy personazhe Njeriu Y dhe Njeriu X, të cilët ne i dimë që ekzistojnë, në të vërtetë disa sozi të tyre bile dhe i njohim, por nuk e di përse hezitojmë t'i demaskojmë apo dhe të


Foto nga promovimi i romanit të Fran Camaj

bëjmë dhe në atë që ata bëjnë me ne. Ata janë armiq e malësori gjithherë ka ditur si të sillet me ta. Tashmë fatkeqësisht baroti ynë është i lagur. Kemi ardhur në një fazë të tillë të urtësimit që larg o Zot mund ta quajmë dhe përulje, pa ditur se përse e kujt duhet t'i përulemi.

Në një familje malësore dy djem Toma e Prëka kërkojnë të nisen në Amerikë, dy të tjerë janë atje, Gjergji dhe Leci. Mbetet vetëm baba Marku, Lula, nëna dhe vëllai i vogël Pali që studion në Prizren, një dramë e rëndomtë dhe një itinerar i ditur me kohë, drejt Italisë e më pas në botën e lirë. Deri këtu gjithkujt i duket si diçka e lexuar më parë diku, apo dhe e jetuar, Një person, Njeriu X i pret dhe i sistemon në një kamp emigrantësh. Pas disa muajsh mbërrijnë në Detroit, atje ku gjashtë vite më parë dy vëllezërit e tyre kishin fjetur parqeve, derisa kishin hasur në Kriston, një shqiptar prej Shqipërisë së Jugut, me të cilin lidhin kumari ma vonë. Është dhe kjo një e vërtetë, ne nuk kemi organizim siç e kanë të tjera komunitete dhe autori siç duket e din një gjë të tillë. Dikur Leci aksidentalisht pret një pjesë të dorës së majtë, por ndërkohë ai dashuron një vajzë. Është njeriu Y ai që fillon të intrigojë derisa arrin t'i vrasë të dy, Lecin dhe vëllanë e Shpresës, të dashurës së tij. Kjo e fundit vetëvritet duke u hedhur nga banesa. Njeriu Y e quan vetëm fillim të tragjedisë atë që ai gatoi, por fatmirësisht e gjitha ndaloi aty - dy shtëpi të përgjakura, dy shtëpi që do të gëzonin e duhej të gëzonin. Vëllai tjetër Toma nuk mund t'i rezistojë jetës së pamoralshme dhe hyn në labirintet e drogës derisa vdes diku në Florida i droguar dhe i vetmuar. Pali vijon në linjën e tij por tashmë i vënë mbikëqyrjen e UDB-ës. Niset në Amerikë për të marrë pjesë në dasmën e Gjergjit dhe për të gjetur varrin e vëllait, Prënkes. Dikush, fantazma e gjyshit i tregon gjithçka, është kjo kleçkë që ia lehtëson rrugën autorit drejt përfundimit të linjave. Pasi gjejnë varrin e Prënkës, ndodh një tjetër aksident automobilistik. Toma nuk është më. Pali kthehet në Malësi dhe sërish është nën vëzhgimin e UDB-ës. Gjergjit i lind djalë, Leci i vogël. Ndërkohë Mark Hasi ka vdekur dhe Lula diku më vonë pasi kalon një krizë çmendurie. Pali vazhdon studimet dhe fejohet me Bukurien. Sidoqoftë në njëfarë mënyre jeta vazhdon, një trung i copëtuar e tash i ndarë më dysh, në Malësi dhe larg në Amerikë.

Të flasësh për një roman të tillë, nuk duhet të jesh njeri i letrave, për një roman të tillë secili prej nesh të pranishëm në këtë sallë mund t'i thoshte dy fjalë e më tej. Është dramë e secilit prej nesh, jemi ne në faqet e atij libri, por nuk kemi dëshirë, nuk na vjen mirë të na e kujtojë kush se çfarë kemi bërë, kë kemi lënë pas, nuk duam të na tregojë kush se Malësia është çereksuar, nuk duam, megjithëse i dimë e ndoshta dhe i njohim ata Njerëzit X dhe Y, nuk duam të na i kujtojë kush bëmat e tyre të djeshme dhe atë që mund të ribëjnë në të ardhmen. I dimë, por nuk duam të veprojmë. Jemi të mire, por jo të vendosur, jemi malësorë, por në një farë mënyre disi të tjetërsuar, flasim tepër për njëri tjetrin pas shpine, gjë që unë kurrë si dhe ju nuk e kemi vënë re te prindërit tonë. Ndoshta na ka mësuar Njeriu X apo Y.


Fran Camaj

Ndaj unë ngul këmbë në atë që Fran Camaj është malësore më i mirë se unë, ndaj unë ngul këmbë në atë që Fran Camaj e donë më fort Malësinë se unë. Dhe jo vetëm se unë.

Më pas fjalën e mori ish nxënësi dhe më vonë kolegu i Franit, ish arsimtari i Gjimnazit të Tuzit, i cili jo vetëm arsimonte nxënësit e vet profesionalisht por u ndezte edhe shpirtin patriot të tyre për vendin dhe kulturën tonë shqiptare. Nga fjala e z. Gjokë Gojçaj veçojmë:

Më vjen shumë mirë që Fondi Humanitar "Malësia", ka përfituar nga shkasi, të na mbledhë këtu, sot, për më tepër në këtë tempull të fesë e të identitetit tonë. Meqë, autorin e këtyre veprave që po e promovojmë para publikut tonë këtu, e kemi në mesin tonë, le ta përshëndesim dhe përgëzojmë publikisht, për punën e tij të bukur, jo vetëm në fushën e artit letrar, por edhe në atë të edukimit, në gazetari, publicistikë e aktivitete tjera, ku ka marrë dhe gjithnjë merr pjesë edhe sot. Në vitin shkollor 1963/64, Frani, pat mbaruar në Arzë shkollën fillore, e menjëherë pas, regjistrohet në Shkollën Normale në Prizren. Normalja, ishte një shkollë pesëvjeçare, që nxirrte kuadro për ciklet e ulëta të mësuesisë. Ndërsa, tërë kohën, po punonte si mësues, në vitin 1971, e mbaroi edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike, dega-Gjuhë e Letërsi Shqipe, kurse në vitin 1976, mbaron edhe studimet universitare, nga e njëjta lëmi, pranë Fakultetit Filozofik të Prishtinës, të cilat i mbaron me suksese shumë të larta. Gjatë katër viteve të ardhshme, konsekutive, pikërisht deri më 1980, Frani do të punojë si profesor në Gjimnazin e Tuzit, prej kur, pastaj, nxënë punë të re - në gazetari.

Fran Camajn, e takova për të parën herë në detyrën e mësuesit. Ai, sapo kishte mbaruar Normalen, e unë sa kisha filluar klasën e pestë fillore në Arzë. Nevojat për njerëz të arsimuar, në atë kohë dhe përgatitja e tij absolute për mësimdhënie, e mirëpritën punësimin e tij të parë, për më shumë, kur edhe po fuste themelet e një punëtori të vërtetë të arsimit, një edukatori, didaktiku e metodisti të dalluar, tipare të cilat, padyshim do të lënë kujtime të pashlyeshme te nxënësit, prindërit e tyre, shokët dhe kolegët e punës. Fillimisht, si mësues, dha lëndët: Biologji, Kimi, Njohuri Natyre, Edukatë fizike, e pastaj edhe lëndën e tij më të dashur – Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe.

Në orën e parë të lëndës Njohuri Natyre, u gjetëm ballë për ballë më mësuesin e ri, atëherë-njëzetvjeçar. Tha, që nuk do e fillonte karrierën e mësuesit, aq herët, po mos të ishin sfidat e shumta me të cilat duhej përballur pa humbur kohë. U punësua për të ndihmuar familjen e vet, meqë, tre nga vëllezërit e tij, asokohe, u nisën për në kampet e Italisë, me destinacion Amerikën, kurse vëllai Paloka gjendej në Prizren duke ndjekur Gjimnazin. Njëkohësisht edhe vëllai dhe motra e vogël shkonin në shkollën fillore. Megjithatë, krahas punës, Frani, vazhdoi shkollimet e mëtejme me korrespondencë, derisa i mbaroi të gjitha me suksese të larta dhe në afat rekord. Fran Camaj, bënë pjesë në kategorinë e atij grupi pedagogesh, që u bëri ballë gjithë ngarkesave që sillte me vete sistemi i shkollimit shqip në Mal të Zi, ku mësimi i kulturës dhe frymës kombëtare, lejohej nga ana e regjimit, vetëm aq sa lëshonte (siç thuhet) "veshi i gjilpërës". Përkitazi me këtë, në orën e tij mësimore, mësohej rrjedhshëm Gjuha Shqipe, siç mësohej në Tiranë dhe Prishtinë, ndërsa letërsia e shkrimtarëve patriotë, të rilindjes shqiptare, ishte ajo që u mësohej nxënësve më me dashuri, por edhe u kërkohej më së shumti. Në këtë lëmi, Frani ishte mjaft "i rreptë" dhe maksimalist.

Gjatë tërë karrierës së tij në procesin e arsim–edukimit, si në Arzë, ashtu edhe në Tuz, Fran Camaj shpaloste aftësitë e tij edhe në aktivitete jashtëmësimore, ku organizonte kuize e gara midis grupeve e paraleleve të shkollës, për të ngjallur më shumë frymën e konkurrencës kreative midis tyre. Ka bërë skenarë, regji dramash e komedish, ka përgatitur recitale, e tjera, të cilat gjithmonë nxënësit i luanin dhe ekzekutonin në cilësinë më të lartë. Më duhet të veçoj edhe këtë fakt: nxënësit, që (siç thuhet), kishin kaluar "nëpër duart" e Franit, dukeshin më të dalluar dhe të binin në sy për aftësitë dhe përvojat e asimiluara nga lënda e

tij, krahasuar me të tjerët që i mësonte dikush tjetër. Madje, edhe studentët malësorë që studionin Gjuhë e Letërsi, në Kosovë, shikoheshin me më konsideratë, për faktin se, profesorët e atjeshëm e njihnin, ose kishin dëgjuar për Franin, si një edukator e arsimtar të mirëfilltë. Fran Camaj, thotë: "E kam dashtë arsimin, më shumë se çdo gjë tjetër". Kurrë, problemet e tij private, s`kanë mundur të reflektohen në punën me nxënës dhe po të ndodhej në situata të shqetësuara, kurrë nuk do t'i pyeste nxënësit për nota, siç mund të bënin disa tjerë, që mund ta përdornin notimin, si një instrument disiplinimi, metodë kjo e papranueshme për pedagogjinë (megjithëse, them, në orën e tij, kurrë nuk ndodhte të prishej rëndi). Franin, e interesonte ajo që e di dhe se si e di,e jo ajo çka nuk e di nxënësi, dhe për çudi, e mbante mënd notën e secilit nxënës, si me gojë, ashtu edhe me shkrim. Hartimit me shkrim i jepte një rëndësi të veçantë. Po qe se nxënësi bënte një hartim të mirë, hidhte çdo dyshim për aftësitë e tij (edhe nëse kishte notën e dobët me gojë), sepse, mu aty Ai, zbulonte aftësitë krijuese të tij.

Nga viti 1980, Frani kalon në punë të re, të një natyre tjetër, pikërisht në gazetari. Fillimisht, punon si spiker e redaktor i programit shqip të Radio Titogradit (të atëhershëm), sot Radio shtetërore e Malit të Zi. Nga viti 1988, kalon në vendin e redaktorit përgjegjës të Televizionit të Malit të Zi, për programin në gjuhën shqipe, ku punon edhe sot.

Nuk duhet harruar fakti se vitet e 80-ta, janë vitet më të vështira, për edukimin dhe arsimimin shqip në Mal të Zi. Lëvizjet asokohe në Kosovë, sollën një reaksion të tërbuar të pushtetit ndaj çdo gjëje që ishte shqiptare. Shkollat shqipe mbetën pa tekste e libra, qe deri atëherë vinin nga Kosova. Për të mbushur sadopak në atë depresion të krijuar, Fran Camaj, me të ndjerin Gjekë Gjokaj, hartuan Abetaren e parë, qe do të jetë edhe teksti i parë, origjinal, në gjuhën shqipe, në Mal të Zi, i një destinacioni të tillë. Më vonë, Frani, së bashku me të ndjerin Gjergj Gjokaj, hartojnë edhe një libër leximi për klasën e tetë të emëruar Rreze, ku të dy këta libra të përmendur, përdoren edhe sot në shkollat shqipe në Mal të Zi.

Fran Camaj është një figurë publike e dalluar dhe e respektuar, jo vetëm në Malësi e më gjerë, por edhe këtu ndër ne, në diasporë. Ai shquhet kudo, jo vetëm si mësues, arsimtar e pedagog i spikatur që ishte, por edhe aktivist i aftë, i zoti, i thjeshtë e modest, në cilëndo cilësi, qoftë si anëtarë, qoftë edhe si drejtues i disa shoqatave e asociacioneve, që veprojnë në Malësi. Spikatet gjithashtu edhe si atdhetar i vërtetë e realist, duke ushtruar detyrën me profesionalizëm aty ku i nevojitej më së shumti vendit dhe popullit tonë shqiptar në Mal të Zi.

Fran Camaj deri tani ka botuar veprat: "Rruga e pamëshirshme", roman (2004), "Dashuri e dhunuar", roman (2006), "Kohët flasin", përmbledhje punimesh publicistike (2007) dhe "Mëshira e pamëshirshme", roman (2008).

## Fondi Humanitar "Malësia" financoi seminarin për nder të 100 vjetorit të alfabetit të Gjuhës Shqipe.

Shoqata "TEUTA" me kryetarin e saj Marjan Lulgjuraj uron të gjithë shqiptarëve gëzuar 100-vjetorin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe

Duke përshëndetur të pranishmit në darkën tuaj për nder të 15 vjetorit të themelimit të Fondit Humanitar "Malësia", këtu përmes faqeve të Revistës suaj dëshiroj të uroj 100-vjetorin e Alfabetit të Gjuhës Shqipe gjithë shqiptarëve kudo që ata ndodhën e posaçërisht shqiptarët e Malit të Zi. Shoqata "TEUTA" me datën 8 nëntor 2008 organizoi një tubim jubilar në QKI "Malësia" në Tuz për këtë përvjetor të rëndësishëm në historinë e shqiptarëve, histori e cila i vuri themelet bazë të një populli.

Në këtë tubim jubilar morën pjesë edhe profesorët e nderuar të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" prof. dr. Tomor Osmani, prof.as. dr. Tefë Topalli dhe dr. Mimoza Priku, të cilët te pjesëmarrësit sollën informacion lidhur me Kongresin e Manastirit që u mbajt më 14 deri 22 nëntor 1908 në Manastir, gjithashtu u fokusuan te intelektualët e veriut në ndihmesën që i dhanë për këtë arritje me vlera mbarëkombëtare, e njëri ndër ta ishte edhe at Gjergj Fishta, veprimtaritë e të cilit na i solli Dr. Mimoza Priku. Prof. dr. Tomor Osmani ligjëroi për Alfabetin e Gjuhës Shqipe dhe Kongresin e Manastirit, ndërsa prof. as. dr. Tefë Topalli u mor me ndihmesën e pararendësve të veriut të Rilindjes Kombëtare për Alfabetin e Shqipes.

Unë si kryetar i kësaj shoqate me kënaqësinë më të madhe u ngjita në foltore të hapi manifestimin dhe të fokusohem në temën e këtij jubileu, dhe njëkohësisht shpreha kënaqësinë për privilegjin që mu dha të drejtohem në këtë tubim me rastin e përvjetorit të 100-të të Alfabetit të Gjuhës Shqipe. Është hera e parë që në Tuz të shprehim respektin tonë të thellë për të gjithë ata që u mblodhën në Manastir dhe vendosën bazën e alfabetit tonë të unifikuar si dhe të reflektojmë të gjithë së bashku për këto vite të kaluara, ku mbi bazën e këtij alfabeti u ndërtuan vlera dhe të arritura të tjera që garantojnë qëndrueshmëri kulturore kombëtare për ne shqiptarët. Unifikimi dhe kodifikimi i alfabetit të shkencës gjuhësore shqipe është vizioni i parë i inteligjencës shqiptare për gjallërimin dhe vitalizimin e gjuhës shqipe, artikulimin e vlerave kulturore dhe shpirtërore.

Dua të falënderojë edhe përmes faqes suaj një tërësi mediesh nga Mali i Zi dhe nga Shqipëria që përcollën këtë tubim jubilar, dhe në veçanti falënderoj Fondin Humanitar "MALËSIA" nga Nju Jorku i cili ishte sponsor i këtij manifestimi me përmasa mbarëkombëtare.

Marjan Lulgjuraj
Kryetar i shoqatës "TEUTA"

## Fondi Humanitar "Malesi" ka ndihmuar financiarisht organizatorin e Festivalit "Rapsha 2005".

Në këtë festival morën pjesë një numër i madh shoqatash kultoro-artistike si nga vendi dhe diaspora, të cilat mbushën Malësinë me tinguj të ëmbël muzikor të shoqëruar me zërin po aq të ëmbël të gjuhës shqipe.



Festivali Mbarëkombëtar Folklorik "Rapsha'

# A R S I M

## Pozita edukative dhe arsimore e shqiptarëve në Mal të Zi

**Prof. dr. David Kalaj**



Prof. dr. David Kalaj

Bashkatdhetar të nderuar,

Është kjo hera e dytë që ndodhem në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe hera e parë që marr pjesë në një manifestim të diasporës. Ndjehem shumë i lumtur që ndodhem midis jush, dhe është një kënaqësi e veçantë t'ju drejtohem. Dua të ceki faktin se kur e mora ftesën tuaj, më preokupuan disa emocione dhe mendime, duke ia parashtruar vetes pyetjen, se çfarë interesante ka për t'u thënë një matematikan. Përkundër herës së parë, kur e vizitova Nju Jorkun, dhe pata një kumtesë në një konferencë matematike në të cilën iu drejtova kolegëve nga profesioni, këtu po ju drejtohem juve vëllezër e motra, shokë e dashamirë, sikur të isha në shtëpinë time.

Jemi bashkuar këtu të kremtojmë jubileun e rëndësishëm të Fondit Humanitar "Malësia". Ky fond u themelua në vitin 1994, si rezultat i vullnetit të mirë të bashkatdhetarëve tonë, në diasporë, gjegjësisht në Nju Jork, me qëllim të pasurimit dhe avancimit të kulturës, arsimit, politikës dhe ekonomisë së shqiptarëve në Mal të Zi, e në veçanti në trevat e Malësisë. Një ndër qëllimet kryesore të fondit, që ishte atëherë dhe vazhdon të jetë edhe sot është mbursimi i studentëve. Në vitin 1994 isha në vitin e tretë të studimeve, kur u "njoftova" me Fondin Humanitar "Malësia". Formimi i këtij fondi, ishte një ngjarje e madhe për ne studentët në atë kohë. Mendoj se atëherë ishte numri minimal i studentëve malësorë që studionin (një fakt shumë alarmant). Më duhet të shtojë faktin se, unë isha një ndër laureatët e parë të kësaj burse. Kam dëshirë të falënderoj Tomë Camaj, të cilin e njoftova atëherë, dhe i cili na sjelli bursën, si dhe të gjithë ata që dhanë kontributin e vetë të madh apo të vogël në ekzistencën e këtij fondi për 15 vite me radhë, një jubile përnjëmend për lëvdatë. Ky fond, përveç tjerash, ka ndihmuar, mos të them se i ka shkolluar, një numër të konsiderueshëm të studentëve nga Malësia. Tani numri i studentëve që studiojnë në Malësi është i madh. Ndoshta disa herë më i madh se në kohën kur studioja unë. Me siguri se në rrethana të tilla, fondi ballafaqohet me sfida më të mëdha.

Për ata që nuk më njohin, po jap një biografi të shkurtër. Shkollën fillore dhe të mesme e kam përfunduar në Tuz, Malësi, studimet universitare ne degën e matematikes i mbarova ne Podgoricë, përkundër dëshirës sime që të studioj në Prishtinë ku kisha regjistruar fakultetin e elektroteknikës. Mirëpo për shkaqe të cilat ju mire i dini, ajo kohe përkonte me kohen kur pushteti i Serbisë abuzonte me sistemin arsimor shqip në Kosovë, dhe si rrjedhojë dëshirat e mija mbetën të parealizuara sa i përket kësaj dege. Studimet e mia kane vazhduar në Beograd, ku kam marr titullin magjistër dhe pastaj doktor i matematikës. Aktualisht jam profesor i matematikës, më saktësisht analizës matematike, në Universitetin e Malit të Zi në Podgoricë. Gjithashtu jam edhe dekan në degën e Programit studimor për arsimimin e mësuesve në gjuhën shqipe, pranë këtij universiteti.

Jam shumë i nxënë me punë shkencore, punë e cila më ka hapur derën në një botë shumë misterioze, dhe shpeshherë imagjinare. Ne matematikanët, nganjëherë kemi epitet të njerëzve të çuditshëm, pikërisht për shkak të faktit, se aplikimi i matematikës moderne është shumë larg jetës së përditshme. Shkenca e matematikës, kërkon një angazhim maksimal dhe një sakrificë, që ndoshta nuk lejon shumë hapësirë për veprimtari në fusha të tjera, që pritet prej një intelektuali të mirëfilltë, posaçërisht kur ndjehet një deficit i tyre. Sidoqoftë më duhet të shtoj faktin se në këtë lëmi ndihëm më komod sesa diku tjetër.

Në vitin 2004, në bashkëpunim me Konsullin Amerikan në Podgoricë, dhe me rektorin e atëhershëm, themeluam Fakultetin e mësuesisë në gjuhën shqipe, udhëheqës i të cilit jam unë. Kisha kënaqësi të veçantë që mora pjesë në një vepër të tillë, që mund ta ceki si kontributin e parë të drejtpërdrejtë për popullin të cilit i takoj. Ky është institucioni i parë i lartë në gjuhën

shqipe në Mal të Zi.

Në trevat etnike në Mal të Zi ekzistojnë 12 shkolla fillore, dhe 4 shkolla të mesme. Ato i frekuentojnë përafërsisht 4500 nxënës. Formalisht, tani ekzistojnë të gjitha premisat për një shkollim të mirëfilltë në gjuhën shqipe. Duke shtuar këtu faktin e hapjeve të kufijve me shtetet etnike Shqipëri dhe Kosovë, mendoj se formalisht, një nxënës shqiptar në Mal të Zi ka një perspektivë të mirë për arsimim adekuat. Mirëpo, mendoj se niveli i dijes, që posedon një nxënës, mbas përfundimit të shkollave tona, apo fakulteteve, ka pësuar një ngecje evidente, edhe krahas zhvillimeve teknologjike dhe informatike bashkëkohore. Dëshiroj të besoj se ky problem është rezultat i tranzicionit i cili po zgjat tepër shumë për ne.

Një ndër problemet kyçe të arsimit, rezultat i të cilit janë problemet e porsapërmendura, është kuadri edukativo-arsimor. Kuadri është i nevojshëm jo vetëm në arsim, por edhe në politikë, në ekonomi, në drejtësi, në bujqësi, në mjekësi, në ndërtimtari etj. Në Malësi kemi deficit të përgjithshëm në këto fusha që i përmenda.

Edhe fakulteti ynë (Fakulteti i mësuesisë) ballafaqohet me një problem permanent, me mungesë të kuadrit. Në degën tonë, një pjesë e konsiderueshme e profesorëve, vijnë nga Shkodra, disa të tjerë nga Prishtina, kurse një pjesë syresh janë nga Mali i Zi. Kemi prodhuar deri tani 20 mësues të diplomuar, dhe mendoj se këta të rinj do të përmirësojnë gjendjen aktuale kritike në arsim fillestar në trevat shqiptare në Mal të Zi (Malësi, Ulqin, Plavë...). Disa nga ato diploma që i kemi dhënë janë më të merituara se disa të tjera. Në cilin kuptim të merituara? Mendimi im është, se mbas një diplome duhet të ekzistojë përafërsisht aq dije sa qëndron mbas një diplome në botën e zhvilluar (Evropë, Amerikë). Fakulteti ka qenë, fryt i projektit të shoqatës intelektuale ILLYRIKUM, me qëllim të renovimit të infrastrukturës kuadrovike të shkollave fillore me mësim në gjuhën shqipe në Malin e Zi.

Do të vazhdojmë të prodhojmë një numër të konsiderueshëm të diplomave, ndoshta më shumë sesa nevojitën, nganjëherë edhe si rezultate të pretekstit se "është patriotike" nëse bëjmë lëshime, siç kam pas rast të dëgjoj nga disa kolegë. Sidoqoftë, ata studentë të cilët dëshirojnë të studiojnë, mendoj se kanë para tyre një mundësi të tillë.

Në kohë të fundit, numri i studentëve të kësaj dege në gjuhën shqipe është zvogëluar, dhe ideja është që të transformohet në një degë tjetër të ngjashme, mirëpo këtu duhet një punë, e cila nuk është e lehtë.

Më lejoni që për në fund të jap një vlerësim mbi premisat e zhvillimit të mirëfilltë të Malësisë dhe trevave të tjera me shqiptarë.

1. Arsimim dhe edukim i mirëfilltë dhe punë serioze e çdo individi në lëmin e vetë,
2. Afirmimi i plotë i identitetit nacional, si popull autokton,
3. Ndalimi i shpërnguljes masovike, dhe përgatitja e kushteve të rikthimit të atyre, të cilët janë shpërngulur përkohësisht nga Malësia, duke kyçur këtu edhe përforcimin e lidhjeve me diasporën në të gjitha sferat,
4. Përfaqësimi në pozitat politike të udhëheqjes dhe organizatave përkatëse nga personat adekuatë.

Po përfundoj këtë kumtesë, duke i uruar "Fondit Humanitar Malësia" këtë përvjetor, dhe duke i dëshiruar një punë të mbarë, në rrugën humane të tij, sidomos në fushën e bursave të studentëve shqiptarë, me dëshirë që këta studentë ta arsyetojnë këtë me veprimtarinë e tyre profesionale. Falëmnderit në vëmendje!

# Aktiviteti i Fondit Humanitar "Malësia" në arsim gjatë 5 viteve të fundit

Në revistën e vitit 2004, revistë të cilën e publikuam me rastin e 10 vjetorit të Fondit Humanitar, ne kemi bërë një pasqyrim historik të aktivitetit tonë në arsim, duke i kushtuar një vend të posaçëm programit arsimor të Fondit për studentët shqiptar. Duke mos dashur të përsërisim quod heri diximus, ju jeni të lutur që të shfletoni revistën e mëparshme apo të shfletoni faqet tona të internetit në mënyrë që të keni një pasqyrë historike të programit arsimor të Fondit Humanitar "Malësia".

Gjatë 5 vjeçarit të kaluar në kemi pasur 213 kandidatë për bursë të Fondit Humanitar "Malësia", prej të cilëve rreth 59% kanë pas aplikim të suksesshëm për bursë. Në njërën anë Bursa jonë ka pas ndikim pozitiv në studentët shqiptar të Mal të Zi, duke rritur numrin e përgjithshëm të studentëve që vijojnë studimet në qendrat universitare shqiptare, por në anën tjetër ajo nuk është paraqit shumë efikase në avancimin e suksesit studimor të vet studentëve përkundër lehtësimit të kushteve të studimit të studentëve, si edhe të mos diversifikimit të profilit studimor sa i përket larmisë së degëve studimore të preferuara nga studentët. Fondi Humanitar në kushte të tilla ishte i detyruar që brenda mundësive t'i përgjigjet kërkesave të kohës, në mënyrë që çështjet e mësipërme të adresohen duke u bërë prioritet kryesor i programit të arsimit. Ne këtë aspekt Fondi në fillim të këtij viti ka aprovuar kushtet shtesë konkurruese për bursë studentore të cilat besojmë se me kohën do të ndikojnë pozitivisht jo vetëm në suksesin studimor por edhe çka është më me rëndësi në diversifikimin e degëve studimore të vet studentëve duke plotësuar nevojat kuadrovike arsimore për sa u përket shqiptarëve në Mal të Zi, respektivisht rajonit të Malësisë.

**Sa më poshtë ju mund të lexoni studentët bursistë gjatë 5 viteve të fundit.**

VITI AKADEMIK 2008-2009

1. Agron Luigj Dushaj Universiteti "Luigj Gurakuqi"
2. Ajeta Beqri Gjokaj Universiteti i Malit të Zi" (Mësuesi)
3. Albert Lucë Camaj Universiteti i Malit të Zi" (Mësuesi)
4. Aldita Brahim Dukaj Universiteti i Prishtinës
5. Ana Kolë Vulaj Universiteti "Luigj Gurakuqi"
6. Anita Nrekë Dreshaj Universiteti i Malit të Zi (Mësuesi)
7. Besa Omer Gjokaj Universiteti i Prishtinës
8. Driton Nikollë Lucgjonaj Universiteti i Malit të Zi (Mësuesi)
9. Driton Pashk Junçaj Instituti "Vojo Kushi" Tiranë
10. Driton Pashk Sinishtaj Universiteti Europian i Tiranës
11. Ilir Nua Sinishtaj Universiteti i Prishtinës
12. Ivan Mark Ivanj Universiteti i Malit të Zi (Mësuesi)
